REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
NR.PROT. 01 / 47
DAT.DT. 27 · 01 · 2020
PRISHTINË

KGJK.nr. 11/2020
Datë: 27 janar 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të Amandamentit nr. 25 të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, 8 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 7, 8 dhe 10 të Rregullores nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori, në takimin e 229 –të, të mbajtur me datë 27 janar 2020, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Shpallet data e zgjedhjes së kandidatit të nominuar nga Gjykata Themelore Gjakovë për anëtar të Këshilit, që do të mbahet në Gjykatën Themelore Gjakovë, me datë 3 shkurt 2020 (E Hënë), duke filluar nga ora 11:00.

II. Aprovohet lista e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Gjakovë që kanë të drejtë vote.

III. Aprovohet Forma e fletëvotimit që do të përdoret me rastin e zgjedhjes së kandidatit të nominuar nga Gjykata Themelore Gjakovë (*draft forma pjesë e vendimit*).

IV. Fletëvotimet që do të përdoret me rastin e zgjedhjes së kandidatit të nominuar nga Gjykata Themelore Gjakovë të printohen në tridhjetë (30) fletëvotime dhe të gjitha fletëvotimet e përdorura për votim duhet të vulosen nga prapa me vulën e KGJK-së.

V. Aprovohet forma e Raportit të Komisionit që do të përdoret me rastin e zgjedhjes së kandidatit të nominuar nga Gjykata Themelore Gjakovë (*draft forma pjesë e vendimit*).

VI. Aprovohet forma e Raportit të Zyrtarit të autorizuar nga Sekretariati i KGJK-së që do të përdoret me rastin e zgjedhjes së kandidatit të nominuar nga Gjykata Themelore Gjakovë (*draft forma pjesë e vendimit*).

VII. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 janar 2020.

Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Gjykatës Themelore Gjakovë;*
- *Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivit.*